



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.115/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gllogjani anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vodosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në hapsirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 5,300.00 (pesëmijë e treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes-pranimit të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli, me datën 06.06.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, në rrëthin e qendrës së qytetit në Dardanë është vendosur një flamur i subjektit politik PDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se koalicioni PDK-AAK-NISMA etj me vendosjen e një flamuri të subjektit politik PDK, konkretisht në rrëthin e qendrës së qytetit ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4 par.1 pika (b), të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka prezantuar PZAP-it, dy fotografi nga vendi ku është vendosur posteri që është objekt lëndor. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të aprovohet dhe ndërmarrjen veprimet ligjor ndaj shkelësit të kodit të mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatëve.

Koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigje në ankesë të datës 07.06.2017, thekson se me të marrë urdhërin për masat e përmirësimit nga PZAP-i, lidhur me rastin Anr.115/2017, konsideron se në rastin konkret, shkelja nuk ekziston sepse në mungesë të hapsirave reklamuese kuvendi komunal i Kamenicës ka lejuar përdorimin e hapsirave dhe objekteve publike. Mëtej në përgjigje në ankesë theksohet se kjo dëshmohet me shkresën e Kuvendit Komunal e cila i bashkangjitet kësaj përgjegje në ankesën Anr.115/2017. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, te cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se flamuri i subjektit politik PDK, është në rrëthim e qendrës së qytetit, e cila çështje nuk është mohuar as nga përgjigja në ankesë e Koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se koalicioni i lartpërmendor ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjeket politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e plakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike*”

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vndimi, ka marrë parasysh rrëthanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrëthanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti se flamuri i subjektit politik PDK janë vendosur në hapsirë publike, gjegjësisht në rrëthim e qendrës së qytetit, po ashtu e njëjtë shkelje nga ky koalicion është përsëritur disa herë në këto zgjedhje.

Me rastin e vendosjes paneli mori parasysh edhe pretendimet e koalicionit të theksuar me lart, që theksohet se shkelja nuk ekziston sepse në mungesë të hapsirave reklamuese Kuvendi Komunal i Kamenicës ka lejuar përdorimin e hapsirave dhe objekteve publike. Këto pretendime paneli i vlerëson si të paqendrushme dhe pa asnjë bazë ligjore sepse flamuri i subjektit politik PDK në rastin në fjalë nuk është i vendosur në vendin e dedikuar për reklama dhe flamuj ashtu siç e kanë edhe vendimin për lejimin e shfrytëzimit të hapësirës publike nga Komuna e Kamenicës, mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë ka ka bërë shkelje të kundërligjshme të parapara në ligjin e sipërcituar më lartë.

Paneli poashtu vlerësoi me rastin e vendosjes, lidhur me gjobën e shqiptuar si në dispozitivë të këtij vendimi, se koalicioni PDK-AAK-NISMA, nuk ka bërë asnjë veprim për ta përmirësuar shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike respektivisht largimin e

eflamurit në rrethin e qytetit edhe pse është urdhëruar nga PZAP-i, me parashtresën e datës 07.06.2017 që ta përmison shkeljen e theksuar më lartë.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 3 par.2 të Rregullës Nr.01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr.115/2017 më datën 07.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevci



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.*